



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____ . _____ .2021

Lënda: Kthim përgjigje

I nderuar

Në vijim të shkresës Tuaj datë 04.02.2021, administruar në Bashkinë Shkodër nr. prot 2160, datë 05.02.2021, Ju informojmë se çështja e punësimit është një ndër sfidat kryesore me të cilat vendi jonë ballafaqohet. Pritshmëritë në këtë drejtim janë të mëdha, prandaj për tu përgjigjur pritshmërive të qytetarëve, Bashkia Shkodër gjatë viteve të fundit ka ndërmarrë disa nisma në drejtim të:

- Përmirësimit të kushteve për fillimin dhe zhvillimin e biznesit.
- Thjeshtimit dhe reduktimit të proçedurave administrative.
- Forcimit të bashkëpunimit institucional me qëllim promovimin e fuqisë punëtore të kualifikuar.

Vlen të përmenden disa nisma në drejtim të forcimit të bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor, bizneseve dhe punëkërkuësve, me qëllim promovimin e forcës aktive të punës dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Gjithashtu kujdes i veçantë është treguar për integrimin e brezave të rinj në ekonomi dhe krijimin e mundësive për iniciativa të ndryshme.

Disa nga aktivitetet stimuluese për nxitjen e zhvillimit të biznesit janë:

- a) Njëpërmjet politikave fiskale, shpërndarjen e drejtë të ngarkesës tatimore:
 - Ulje deri në 30% të taksës së pronës (ndërtesës dhe tokës bujqësore);
 - Mundësimi në e shlyerjes së detyrimit me këste, çdo muaj për bizneset dhe familjet;
 - Përcaktimin e nivelit të tarifës sipas llojit të aktivitetit;
 - Përcaktimin e nivelit të tarifës sipas vendndodhjes gjeografike, duke lehtësuar bizneset në zonat më pak të zhvilluara (Taksa dhe tarifa të reduktuara deri në 50 % për subjektet që ushtrojnë aktivitet në Njësi Administrative).
 - Përfshirja nga detyrimet tarifore të bizneseve gjatë periudhës së pandemisë.

- b) Krijimi i platformës elektronike ‘**Taksat e mia**’, ofrimi i shërbimeve online në të gjitha njësitë administrative. Nëpërmjet kësaj platforme, qytetari mjafton të zgjedhë njësinë administrative dhe të plotësojë të dhënat personale dhe informohet menjëherë për detyrimet e veta vjetore. Për me shumë informacion vizitoni linkun <https://buxheti.info/shkoder/taxcalculator.aspx>
- c) Krijimi dhe funksionimi i platformës “**Tregu i Punës Shkodër**” - Për herë të parë në vendin tonë është krijuar platforma e përbashkët “Tregu i Punës Shkodër”, me financim të qeverisë austriake (projekti Seed). Një instrument i cili sjellë sëbashku të gjithë aktorët përgjegjës për çështjet e punësimit, duke ofruar mbështetje në drejtim të aksesit në shërbimet e punësimit, edukimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional. Kjo platformë është pjesë integrale e faqes web të bashkisë.
- d) Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit të biznesit vendore nëpërmjet iniciativave financiare.
- Bashkëpunimi me zonën e përmirësimit të biznesit BID Shkodër. Bashkëpunimi me zonën e përmirësimit të biznesit BID Shkodër në rrugën 13 Dhjetori dhe 28 Nëntori. Nga ky bashkëpunim përfitojnë 120 biznese. Po ashtu në mbështetje të biznesit dhe investorëve vendas dhe të huaj, me shumë interes është realizimi i botimeve dhe materialeve promocionale si: Profili i Bashkisë, Profili i Bizneseve, broshura Investo në Shkodër. Të gjithë këto dokumenta janë realizuar në bashkëpunim me bizneset që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Bashkisë Shkodër.
 - Mbështetja e iniciativave të reja të Zonave Tregtare - Iniciativa të tilla kanë të bëjnë me krijimin e lehtësirave infrastrukturore të nevojshme për zhvillimin e zonave të reja tregtare si dhe nxitjen e kulturës së sipërmarrjes duke ju përgjigjur zhvillimeve të reja në kohë dhe në mënyrë krijuese. Konkretizimi i ndërhyrjeve në zonat karakteristike të Shkodrës të cilat kanë një potencial të lartë për kthimin e tyre në atraksione turistike dhe integrimi i tyre me ofertën turistike, përfaqësojnë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të saj. Prandaj është me shumë interes krijimi i një mjedisi të përshtatshëm për terheqjen e investimeve në zonat e përmirësimit të biznesit dhe organizimin e veprimtarive kulturore - artistike në mënyrë që të rrisim numrin e vizitorëve dhe kohën e qëndrimit jo vetëm përgjatë sezonit veror, por gjatë gjithë vitit. Nisma të tilla nuk kanë munguar edhe më përpara, mjafton të përmendim projektin “BID Shkodra” përgjatë rrugëve “13 Dhjetori”, “28 Nëntori” dhe “Kolë Idromeno” por është e nevojshme shtrirja e tyre edhe në zona të tjera historike të Shkodrës, ku pa dyshim Shkodrës nuk i mungojnë. Të tilla mbështetje do të ndikojnë në përmirësimin e aksesit ndaj shërbimeve bazë, gjenerimin e të ardhurave dhe krijimin e vendeve të lira të pune.
- e) Mbështetja e bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare. Me qëllim mbështetjen dhe lehtësimin e bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare, Bashkia Shkodër ka ndërmarrë organizimin e një sërë sesionesh informuese me rreth 100 biznese, në bashkëpunim edhe me Delegacionin e

Bashkimit Evropian si dhe me ambasadat e ndryshme, të cilët lançojnë thirrje për projekt propozime me qëllim mbështetjen e sipermarrjeve të reja, të tilla si IPARD, CHALLENGE FUND, etj.

- f) Nxitja në kërkim dhe zhvillim për bizneset e reja dhe atyre ekzistuese - Bashkia Shkodër synon nxitjen e veprimtarive mbështetëse për zhvillimin e bizneseve të reja dhe atyre ekzistuese duke nxitur punësimin dhe duke ndikuar në zhvillimin e qendrushëm ekonomik të saj. Një ndër iniciativat më të rëndësishme të nxitjes së biznesit është inkubatori i biznesit. Tashmë Bashkia Shkodër ka ngritur infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e inkubatorit të biznesit. Vendosja në dispozicion e hapsirave të përshtatshme për zhvillimin e biznesit do të jetë në fokus të Bashkisë Shkodër. Inkubatori si në aspektin e hapësirës fizike ashtu edhe në atë të zhvillimit të shërbimeve për mbështetjen e biznesit do të ofrojë asistencë për të gjeneruar idetë e biznesit në sipërmarrje të reja. Ndër të tjera inkubatori do të shërbejë si një përvojë e mirë për të zhvilluar planet e biznesit dhe për të lehtësuar aksesin e tyre ndaj informacionit. Një tjetër fokus i rëndësishëm do të jetë nxitja e bashkëpunimi midis ndërmarrjeve të ndryshme me qëllim nxitjen e shërbimeve të përbashkëta dhe krijimin e zinxhirit të vlerave. Marrë në konsideratë faktin se një pjesë e mirë e bizneseve që ushtrojnë vepimtarinë e tyre në territorin e Bashkisë Shkodër janë biznese prodhuese, është me shumë rëndësi krijimi i një logo për produktet vendore të Bashkisë Shkodër dhe me pas promovimin e tyre “Made in Shkodra” nëpërmjet pjesëmarrjes në panaire, konferenca, tryeza rajonale, etj. Krijimi i një logoje e cila garanton sigurinë e cilësisë së produkteve është një hap shumë i rëndësishëm për të rritur aksesueshmërinë e produkteve në tregje të ndryshme. Kjo logo do të përfaqësojë jo vetëm produktet bujqësore, por edhe ato të akuakulturës, peshkimit, blegtorale, artizanale, turistike etj. Në të do të përshkruhen në detaj prejardhja e produkteve dhe mënyra e prodhimit të tij.
- g) Bashkëpunimi i përvitshëm me artizanët, pjesë e shoqatës së artizaneve. Aktivitetet organizohen mbi bazën e një kalendari të mirë përcaktuar dhe janë 17 të tilla, gjithsej 65 ditë. Iniciativa të tilla jo vetëm ndikojnë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore por ndikojnë edhe në zhvillimin ekonomik.
- h) Bashkëpunimi me bizneset prodhuese, promovimi i trashëgimisë kulturore dhe produkteve vendore. Njohja e territorit dhe promovimi i vlerave të tij në funksion të zhvillimit ekonomik dhe social është një nga prioritetet kryesore të politikave zhvilluese të Bashkisë Shkodër. Integrimi i këtyre elementeve me ofertën turistike, përfaqësojnë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të territorit. Jo pa qëllim Bashkia Shkodër realizon 11 aktivitete promovuese në 11 njësi administrative: ***Të promovohen vlerat e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe produkteve vendase të 11 njësive administrative por mbi të gjitha të kthehet vemendja*** ndaj këtyre zonave, të cilat mbartin vlera të medha të trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Theksojmë faktin se Bashkia Shkodër vit pas viti rrit numrin e bashkëpunëtorëve në nisma të tilla, përmendim këtu bashkëpunimin me Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë Shkodër dhe donatorë të huaj. Gjithashtu duke marrë në

konsideratë potencialin natyror që territori i Bashkisë Shkodër disponon, ku bujqësia, blegtoria apo pylltaria përbëjnë sektorin kyç të përdorimit të tokës dhe menaxhimin e resurseve natyrore në zonat tona rurale, Bashkia Shkodër e sheh me shumë prioritet zhvillimin e metejshëm të këtij sektori dhe integrimin e tij me ofertën turistike dhe e konsideron një pikë të fortë për zhvillimin e mëtejshëm të agro-turizmit dhe eko-turizmit.

- i) Bashkëpunimi me USAID për krijimin e agrobiznesit në NJ.A Ana e Malit dhe Guri i Zi, e cila ka për qëllim mbështetjen e sipërmarresit me mjetet e nevojshme për të nxitur risinë, krijuar vende pune dhe ndërtuar ekonomi të zhvilluara. Gjatë vitit 2020 Bashkia Shkodër përzgjedhi këtë model, si një shembull suksesi në zhvillimin rural për ta përcjellë në të gjitha njësitë administrative.
- j) Organizimi i Panairit të Punës dhe Biznesit, tashmë një aktivitet i përvitshëm i cili përveç partnerëve të përhershme vendor, Drejtoria Rajonale e Punësimit Shkodër, Qendra e Formimit Profesional, Universiteti Luigj Gurakuqi, shkollat profesionale (Shejnaze Juka, Hamdi Bushati, Shkolla Kolë Margjini, Shkolla Peter Mahringer, Shkolla Arben Broci), QAFS Maria Ndihmëtaria, Kurse profesionale private Arti i Guzhinës, Ky aktivitet ka gjetur mbështetjen e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe donatorëve të huaj. Angazhimi i një numri të madh partnerësh vendor dhe ndërkombëtar, i cili sa vjen e shtohet, është tregues i forcimit të këtij bashkëpunimi.
- k) Krijimi i qendrës rinore Atelie – Qendra shërben si një hapësirë gjithëpërfshirëse për rininë e Bashkisë Shkodër duke zhvilluar një sërë aktiviteteve shumë dimensionale për të rinjtë dhe nga të rinjtë, të tilla si:
 - Zbatimi i start up për të rinjtë në kuadër të projektit Yes Future/Programi IADSA nga e cila janë financuar 4 startup biznese.
 - Dhënie e shërbimeve për nxitjen e punësimit pranë Qendrës Rinore “Atelie”: Asistim i të rinjve në aplikim për punësim pranë zyrave të punës; Asistim i të rinjve në hartimin e miniplanëve të biznesit; Asistim i të rinjve në hartimi e CV-ve dhe letrave të motivimit. Ndërmjetësim i të rinjve për punësim në biznese dhe organizata lokale, etj.
 - Bashkëpunimi me organizatat lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë për synim formimin e të rinjve në sipërmarrje dhe ndërgjegjësimin e tyre në tregun e punës, në bashkëpunim me të cilat janë realizuar takime dhe workshop pranë Qendrës Rinore “Atelie”: trajnim mbi sipërmarrjen me të rinj të rikthyer nga emigracioni, workshop sipërmarrje; takim me histori suksesi në sipërmarrje; workshop promovim dhe nxitje të biznesit të artizanatit; edukim për realizimin e aplikimit profesional për punë ose kualifikim profesional, këshillim karriere, planifikim në karrierë, krijimi i Planit të Veprimit Lokal për Rininë; marrëveshja me Caritas për fuqizimin e të rinjve në sipërmarrje dhe nxitjen e punësimit tek të rinjtë.

Të gjitha aktivitetet e listuara me sipër i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër:

Dokumenta strategjike

http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/strategjia_territoriale_1942.pdf

Buxheti i vitit 2021

http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Buxheti_2021_1791_1.php

Bashkia Shkodër mbetet e hapur për çdo bashkëpunim të mundshëm për integrimin e brezave të rinj në ekonomi dhe krijimin e iniciativave të reja.

Me respekt,

KRYETAR

Voltana Ademi